PSH.nr.825/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik: "JONI TRAVEL" SH.P.K.; N.T.P "DITA"- Skenderaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë o operatori ekonomik: NPT "Union"- Mitrovicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbime të transportit për QB Nëna Terezë Mitrovicë jugore dhe shkolla speciale Buzhuri i Kosovës në Mitrovicën e veriut)", me nr. të prokurimit: 208 Udhëheqësi-20-3492-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Ministria e Arsimit, më datën: 13.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik "JONI TRAVEL" SH.P.K.; N.T.P "DITA"- Skenderaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime të transportit për QB Nëna Terezë Mitrovicë jugore dhe shkolla speciale Buzhuri i Kosovës në Mitrovicën e veriut)", me nr. të prokurimit: 208 Udhëheqësi-20-3492-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Ministria e Arsimit.

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbime të transportit për QB Nëna Terezë Mitrovicë jugore dhe shkolla speciale Buzhuri i Kosovës në Mitrovicën e veriut)", me nr. të prokurimit: 208 Udhëheqësi-20-3492-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Arsimit, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e Grupi i operatorëve ekonomik: "JONI TRAVEL" SH.P.K.; N.T.P "DITA"- Skenderaj, aprovohet pjesërisht si e bazuar i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Grupi i operatorëve ekonomik "JONI TRAVEL" SH.P.K.; N.T.P "DITA"- Skenderaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 19.10.2020 me nr. 825/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbime të transportit për QB Nëna Terezë Mitrovicë jugore dhe shkolla speciale Buzhuri i Kosovës në Mitrovicën e veriut)", me nr. të prokurimit: 208 Udhëheqësi-20-3492-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Ministria e Arsimit, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59 dhe 69.4 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.10.2020, ka autorizuar eksperten shqyrtuese të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 03.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:
Sqarim hyrës: AK - Ministria e Arsimit gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është shërbim. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratë, përkatësisht OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk e mbulon kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional. Parashtruesi i ankesës ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim sipas afateve të parapara me LPP. AK përmes vendimit ka refuzuar kërkesën si të pa bazuar të OE ankues, me arsyetimin si në letër standarde.

<u>Përgjigje ne pretendimet ankimore (Neni 113)</u> OE *"JONI TRAVEL" SH.P.K.; N.T.P "DITA"*- Skenderaj
OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar këto kërkesa, konkretisht

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, ku në FDT është kërkuar:

1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se ngjashme në tri vitet e fundit dhe vlera e tyre ka qenë minimum 182.250.00€ euro.

Më, tej OE ankues shton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar, kontrata jo konform kërkesave të dosjes se tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron se tek kërkesa mbi kapacitetit teknik dhe profesional, AK ka kërkuar:

1. **Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se ngjashme në tri vitet e fundit dhe vlera e tyre ka qenë minimum 182.250.00€ euro.**

   Dëshmia e kërkuar dokumentare

   1) Për piken 1. Një Listë e kontratave të natyrës se ngjashme të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit duke saktësuar sherbimet e kryera, shumën e kontratës vendin, datën si dhe nr e prokurimit, kjo listë duhet te jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga kompania (origjinal), po ashtu duke i bashkangjitur referencat përkatëse ose raportet e pranimit si dëshmi se kontrata është përmbushur me sukses. (kopje).

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë përmes ofertës ka prezantuar një listë të projekteve, të realizuara gjithsej pesë (5) projekte, për vitin 2015,2016,2017 si në vijim:

N.P.T."UNION"

TEL:044 213-621 & 028 535-004
Mitrovice

LISTA E KONTRATAVE TE REALIZUARA NE 3 VITET E FUNDIT (2015, 2016, 2017)

Nr.	Titulli i kontrates	Data e nenshkrimit te kontrates	Vlera e ekzekutuar e kontrates	Data e përfundimit te kontrates
1	Transporti i nxenesve te shkollave filiore me mesim te obliguar ne teritorin KKMITROVICES	22.09.2016 Nr.pr:642/14/037/221 10.04.2018 Nr.pr:642/17/0542/211	Rreth 100.000euro RRETH 80.000euro	22.03.2018 10.04.2021
2	Ministria e arsimit shkences dhe e teknologjis -MASHT	16.10.2015 Nr.pr:208016009221 28.09.2018 Nr.pr:208018027221	Rreth 148.000euro Rreth 85.000euro	22.09.2017 28.09.2020
3	OJQ "MUNDESIA" Mitrovice	01.01.2020	Simbas sherbimeve transportuese	31.12.2020
4	Transporti humanitar i udhetareve me autobus LotiXV	20.08.2016 Nr.pr:MI-16-076-2.1.1 12.10.2017	Rreth 19.000euro Rreth 20.000euro	20.08.2017 12.10.2018

Ne cdo koh jeni te miresearduhr per verifikim ose jau deshmojm me dokumentacion te kontratave origjinale

Me respekt

Drejtor KADRIJE DEGI

N.P.T. "UNION"

Megjithëse OE i rekomanduar për kontratë ka cekur kontratat si më lartë, eksperti shqyrtues sqaron se pas shqyrtimit të këtyre kontratave dhe referencave, rezulton se kontrata kornizë me nr.054/2017 e lidhur me datë 10.04.2018 deri me datë 09.04.2021 nuk ka përfunduar ende sepse është në realizim e sipër dhe për këtë kontratë nuk mund të merret referencë apo raport për pranimin e punëve se kontrata është përmbushur me sukses sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Kontrata tjetër e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë është kontrata e lidhur me MASHT me datë 08.09.2016 kurse referenca për këtë kontratë është e datës 31.05.2018. Për këtë kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se pasi që kërkesa e FDT-së është që referencat dhe punër e kryera duhet të jene brenda tri viteve (20.07.2017-20.07.2020) dhe duke pasur parasysh që kontrata në fjalë është nënshkruar gati një vit para publikimit të njoftimit për kontratë, kurse referenca është lëshuar në vitin 2018, atëherë komisioni i vlerësimit do duhej që të sqaronte sa është vlera e realizimit të kësaj kontratë pas datës 20.07.2017 (njoftimit për kontratë).

Pastaj, kontrata tjetër e prezantuar nga OE i rekomanduar, ku në këtë kontratë është në konsorcium me OE "Toni Turist" dhe e lidhur me MASHT me datë 28.09.2018, eksperti shqyrtues sqaron se për këtë kontratë do duhej që AK ta sqaronte sa është vlera e kryer e punëve nga OE i rekomanduar "UNION", në pajtim me pyetjen numër 26 të publikuar në KRPP, ku sipas këtij interpretimi referenca e lëshuar në emër të konsorciumit mund të pranohet nga autoriteti kontraktues në proporcion me përqindjen (%) e punëve të kryera nga secili anëtar i grupit të operatorëve ekonomik.

Sa i përket kontratave nga numri rendor 28 deri në numrin rendor 38 dhe të cilat gjenden në follderin "3.kontratat dhe referencat", të gjitha këto kontrata dhe referenca janë para datës së publikimit të njoftimit për kontratë (20.07.2020). Rrjedhimisht, këto referenca dhe kontrata nuk janë konform FDT-së.

Andaj, eksperti konsideron se ky pretendim është i bazuar dhe i rekomandon AK-së që gjatë rivlerësimit të sqaroj shumën e punëve të kryera sipas kontratave dhe referencave, ashtu siç janë dhënë sqarimet më lartë.

<u>Si provë së bashku me raport gjeni listën e kontratave të prezantuar në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, referencat dhe kontratat.</u>

2. Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues JONI TRAVEL" SH.P.K.; N.T.P "DITA"- Skenderaj, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën tjetër, si **2. Mjetet për realizimin e transportit rrugor. - Duhet të posedoj 6 kombibus.** OE ankues shton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar mjete të transportit jo konform kërkesave konkretisht: 1 kombibus duhet të ketë pjerrinë – rampë për bartjen nxënës me karroca (HEBEBIN, si dhe autmjete te tjera të pa regjistruara qe nuk i plotëson kërkesat e FDT.

Eksperti shqyrtues sqaron se tek kërkesa mbi kapacitetit teknik dhe profesional, AK ka kërkuar:

2. Mjetet për realizimin e transportit rrugor. - Duhet të posedoj 6 kombibus

Dëshmia e kërkuar dokumentare

2. Të dëshmoj se posedon mjete te mjaftueshme për realizimin e transportit rrugor. 5 kombibus të jenë normal, 1 kombibus duhet të ketë pjerrinë – rampë për bartjën nxënës me karroca (HEBEBIN). Të dëshmohen përmes librezave, kobibusët duhet të jenë me regjistrim. - Kombibuset duhet te jene te vegjël 8-10 ulëse, sepse duhet te merren nxënësit edhe neper rrugica te ngushta. - Njeri nga kombibuset duhet te ketë pjerrina -rampen) për nxënësit me karroca (HEBEBIN). - Klimë për ngrohje gjatë kohës së dimrit kur është ftohte dhe për ftohje gjate verës kur është nxehtë. - Karriget te kenë rripin e sigurisë për secilin nxënës. - Ndihma e pare ne gjendje te regullt.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë përmes ofertës ka prezantuar këto mjete:

1. Ford kombi me 9 ulëse, me regjistrim deri me datë 13.12.2020 dhe me targa të regjistrimit 02-949-BO;
2. Volksëagen kombi bus me 9 ulëse, me regjistrim deri me 15.07.2021 dhe tabela 02-103-AE, ka marreveshje për qira;
3. Volksvagen kombi me 7 ulëse, me regjistrim deri me 03.12.2020 dhe tabela 02-790-DR, ka marreveshje per qira;
4. Volksvagen kombi 8 ulese, me regjistrim deri me 03.08.2021 dhe me tabela 02-190-DR, ka marreveshje per qira;
5. Volksvagen 70xOB me 9 ulëse, me regjistrim deri me 20.11.2020 dhe me tabela 02-837-CI, Ka marrëveshje për qira;
6. Volksvagen Typ me 7 ulëse, me regjistrim deri me 28.01.2021 dhe me tabela 02-328-BP, Ka marrëveshje për qira;
7. Mercedes Benz 416 për 25 udhëtar, me tabela 02-253-DD dhe me regjistrim deri me 01.06.2021, CDI 904.6, AUTOBUS 3 DYER;
8. Minibus 3 për 20 udhëtar, tabela 02-458-DH, regjistrim deri me 25.11.2020, ka marrëveshje;
9. Mercedes 410 për 20 udhëtar, regjistrim deri me 13.12.2020, tabelat 02-650-CM;
10. Mercedes Mini bus per 20 udhëtar, regjistrim deri me 22.06.2021, tabela 678-KS-763.

Për mendimin e ekspertit shqyrtues, këto mjete nuk e plotësojnë kërkesën e AK-së. Megjithatë, AK gjatë ri-vlerësimit duhet të kërkoj sqarime shtesë dhe të sigurohet nëse OE i rekomanduar e plotëson këtë kërkesë me listën e mjeteve të cekura si më lartë dhe të vërtetoj se kombibus *1 kombibus duhet të ketë pjerrinë – rampë për bartjën nxënës me karroca HEBEBIN*, se a e posedon i njeti. Andaj, pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Përfundimisht, sipas asaj qe u përshkrua si me lartë vlerësimi ynë është se AK, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave nuk e ka bëre konform nenit 59, përkatësisht nenit 7, të LPP-së. Prandaj propozimi ynë për AK, është qe përmes ri vlerësimit të ofertave ti aplikoi në tërësi dispozitat e LPP-së, në mënyrë qe të pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave të dosjes se tenderit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e dhëna në këtë raport propozimi ynë është qe ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, propozimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në **Ri vlerësim**.

Autoriteti Kontraktues me datë 06.11.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Ne si AK i kundërshtojmë plotësisht pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi, lidhur me tenderin Shërbime të transportit për QB Nëna Terezë Mitrovicë jugore dhe shkolla speciale Buzhuri i Kosovës në Mitrovicën e veriut, me numër të prokurimit: 208 Udhëheqësi-20-3492-2-2-1 . Gjithashtu e kundërshtojmë në tërësi ekspertizën e ekspertit me nr. 825/20 të pranuar me datë 03/11/2020.

- Eksperti shqyrtues, nuk ka konstatuar drejt gjendjen faktike lidhur me objektin e shqyrtimit, pasi që nuk është dashur që të lëshohet në pretendimet ankimore të ankuesit, sepse pretendimet ankimore në ankesën e dorëzuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit, janë të ndryshme nga pretendimet e parashtruara në Kërkesën për Rishqyrtim në Autoritetit Kontraktues - MASH.

Në kërkesën për Rishqyrtim, OE ankues, ka bërë ankesë vetëm lidhur me qasjen në dokumentacionin e tenderit, e cila ankese është demantuar nga ana jonë si MASH, pasi që i njëjti ka pasur qasje në dokumentacione, është përpiluar procesverbali mbi qasje dhe të njëjtin e ka nënshkruar pa vërejtje.

Në Organit Shqyrtues të Prokurimit, OE ankues, pretendon se është shkelur neni 7, 59 dhe 69.4 të LPP-së, duke aluduar se OE i rekomanduar si fitues nuk i plotëson kriteret lidhur me kapacitetet teknike profesionale dhe ekonomiko financiar.

Eksperti shqyrtues, nuk është dashur të lëshohet në asnjërin nga pretendimet ankimore të cilat nuk kanë qenë pretendime në kërkesën për rishqyrtim. Se pasi Zyrtari përgjegjës i prokurimit është dashur ti shqyrtoj pretendimet ankimore dhe pastaj nëse OE ankues është i pa kënaqur me vendimin e AK, te parashtroj ankese pranë OSHP-se, lidhur me pretendimet e njëjta, dhe në asnjë mënyrë me pretendimet e ndryshme.

Kjo është arsyeja e parë pse ne si AK kërkojmë të refuzohet ankesa.

- Lidhur me mendimin e ekspertit se OE fitues nuk ka përmbushur qarkullimin, edhe ky pretendim është i pa qëndrueshëm. OE fitues e përmbushë kriterin e kërkuar, ka referenca të mjaftueshme për ta përmbushur ketë kriter. I njëjti ka referenca adekuate për shërbimin e transportit me nxënës me nevoja të veçanta, të cilat referenca janë adekuate, por, të cilat nuk i posedon edhe ankuesi. Duhet ta keni parasysh së shërbimi i transportit për fëmije me nevoja te veçanta, është shume specifik dhe duhet të kenë qasje të veçanta, shumë të specializuar për te realizuar ketë shërbim. OE ankues asnjë here nuk ka realizuar shërbime të transportit për fëmije me nevoja te veçanta.

Duhet ta keni parasysh edhe parimin e ekonomicitetit, OE i rekomanduar nga MASH ka çmimin më të ulët dhe është i përgjegjësen, edhe kjo është një arsye tjetër për ta refuzuar ankesën.

Lidhur me pretendimin tjetër ankimor dhe me mendimin e ekspertit qe ka te beje me kapacitetet teknike profesionale gjegjësisht me aludimin se disa kombibusët kanë nga 7, 8 dhe disa nga 9 ulëse, ne si AK konsiderojmë se edhe ky kriter është përmbushur në tërësi. Me mjetet e prezantuara nga OE fitues, mund të përmbushet kontrata pa asnjë problem dhe kombibusët i përmbushin kërkesat e përcaktuara në DT.

Qëllimi i AK, ka qenë që OE të ofertojnë me kombibus sa më të vegjël, sepse nxënësit – fëmijët me nevoja të veçanta, duhet ti marrin dhe ti kthejnë në shtëpitë e tyre. Disa rrugica për në shtëpitë e nxënësve janë shumë te ngushta, nëse kombibuset janë më të mëdhenj, nuk kanë mundësi për të shkuar deri të shtëpitë e nxënësve, kështu që shërbimi i transportit nuk mund të realizohet.

Duke u bazuar ne ketë që u cek më larte, kërkojmë nga ju si OSHP, që ankesa e OE dhe mendimi i ekspertit të hodhën poshtë si të pa bazuara, të aprovohet vendimi i AK, dhe të procedohet me njoftimin mbi dhënien e kontratës.

Operatori Ekonomik me datë 05.11.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 13.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "JONI TRAVEL" SH.P.K.; N.T.P "DITA"- Skenderaj se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar këto kërkesa, konkretisht Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, ku në FDT është kërkuar:

1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se ngjashme në tri vitet e fundit dhe vlera e tyre ka qenë minimum 182.250.00€ euro.

Më tej, OE ankues shton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar, kontrata jo konform kërkesave të dosjes se tenderit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues se tek kërkesa mbi kapacitetit teknik dhe profesional, AK ka kërkuar:

1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se ngjashme në tri vitet e fundit dhe vlera e tyre ka qenë minimum 182.250.00€ euro.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1) Për piken 1. Një Listë e kontratave të natyrës se ngjashme të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit duke saktësuar sherbimet e kryera, shumën e kontratës vendin, datën si dhe nr e prokurimit, kjo listë duhet te jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga kompania (origjinal), po ashtu duke i bashkangjitur referencat përkatëse ose raportet e pranimit si dëshmi se kontrata është përmbushur me sukses. (kopje).

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë përmes ofertës ka prezantuar një listë të projekteve, të realizuara gjithsej pesë (5) projekte, për vitin 2015,2016,2017, ku këto kontrata janë bashkangjitur raportit të ekspertizës.

Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas shqyrtimit të këtyre kontratave dhe referencave, rezulton se kontrata kornizë me nr.054/2017 e lidhur me datë 10.04.2018 deri me datë 09.04.2021 nuk ka përfunduar ende sepse është në realizim e sipër dhe për këtë kontratë nuk mund të merret referencë apo raport për pranimin e punëve se kontrata është përmbushur me sukses sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Kontrata tjetër e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë është kontrata e lidhur me MASHT me datë 08.09.2016 kurse referenca për këtë kontratë është e datës 31.05.2018. Për këtë kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se pasi që kërkesa e FDT-së është që referencat dhe punët e kryera duhet të jenë brenda tri viteve (20.07.2017-20.07.2020) dhe duke pasur parasysh që kontrata në fjalë është nënshkruar gati një vit para publikimit të njoftimit për kontratë, kurse referenca është lëshuar në vitin 2018, atëherë komisioni i vlerësimit do duhej që të sqaronte sa është vlera e realizimit të kësaj kontratë pas datës 20.07.2017 (njoftimit për kontratë). Pastaj, kontrata tjetër e prezantuar nga OE i rekomanduar, ku në këtë kontratë është në konsorcium me OE "Toni Turist" dhe e lidhur me MASHT me datë 28.09.2018, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se për këtë kontratë do duhej që AK ta sqaronte sa është vlera e kryer e punëve nga OE i rekomanduar "UNION", në pajtim me pyetjen numër 26 të publikuar në KRPP, ku sipas këtij interpretimi referenca e lëshuar në emër të konsorciumit mund të pranohet nga autoriteti kontraktues në proporcion me përqindjen (%) e punëve të kryera nga secili anëtar i grupit të operatorëve ekonomik.

Sa i përket kontratave nga numri rendor 28 deri në numrin rendor 38 dhe të cilat gjenden në follderin "3.kontratat dhe referencat", të gjitha këto kontrata dhe referenca janë para datës së publikimit të njoftimit për kontratë (20.07.2020). Rrjedhimisht, këto referenca dhe kontrata nuk janë konform FDT-së. Andaj, pretendim i OE ankues është i bazuar

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se AK-së gjatë rivlerësimit të sqaroj shumën e punëve të kryera sipas kontratave dhe referencave, ashtu siç janë dhënë sqarimet më lartë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "JONI TRAVEL" SH.P.K.; N.T.P "DITA"- Skenderaj, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën tjetër, si 2. Mjetet për realizimin e transportit rrugor. - Duhet të posedoj 6 kombibus. OE ankues shton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar mjete të transportit jo konform kërkesave konkretisht: 1 kombibus duhet të ketë pjerrinë – rampë për bartjen nxënës me karroca (HEBEBIN, si dhe automjete te tjera të pa regjistruara qe nuk i plotëson kërkesat e FDT.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se tek kërkesa mbi kapacitetit teknik dhe profesional, AK ka kërkuar:

2. Mjetet për realizimin e transportit rrugor. - Duhet të posedoj 6 kombibus

Dëshmia e kërkuar dokumentare

2. Të dëshmoj se posedon mjete te mjaftueshme për realizimin e transportit rrugor. 5 kombibus të jenë normal, 1 kombibus duhet të ketë pjerrinë – rampë për bartjën nxënës me karroca (HEBEBIN). Të dëshmohen përmes librezave, kobibusët duhet të jenë me regjistrim. - Kombibuset duhet te jene te vegjël 8-10 ulëse, sepse duhet te merren nxënësit edhe neper rrugica te ngushta. - Njeri nga kombibuset duhet te ketë pjerrina -rampen) për nxënësit me karroca (HEBEBIN). - Klimë për ngrohje gjatë kohës së dimrit kur është ftohte dhe për ftohje gjate verës kur është nxehtë. - Karriget te kenë rripin e sigurisë për secilin nxënës. - Ndihma e pare ne gjendje te regullt.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë përmes ofertës ka prezantuar këto mjete:

1. Ford kombi me 9 ulëse, me regjistrim deri me datë 13.12.2020 dhe me targa të regjistrimit 02-949-BO;
2. Volksvagen kombi bus me 9 ulëse, me regjistrim deri me 15.07.2021 dhe tabela 02-103-AE, ka marreveshje për qira;
3. Volksvagen kombi me 7 ulëse, me regjistrim deri me 03.12.2020 dhe tabela 02-790-DR, ka marreveshje per qira;
4. Volksvagen kombi 8 ulëse, me regjistrim deri me 03.08.2021 dhe me tabela 02-190-DR, ka marrëveshje për qira;
5. Volksvagen 70xOB me 9 ulëse, me regjistrim deri me 20.11.2020 dhe me tabela 02-837-CI, Ka marrëveshje për qira;
6. Volksvagen Typ me 7 ulëse, me regjistrim deri me 28.01.2021 dhe me tabela 02-328-BP, Ka marrëveshje për qira;
7. Mercedes Benz 416 për 25 udhëtar, me tab 02-253-DD dhe regj deri me 01.06.2021, CDI 904.6, AUTOBUS 3 DYER;
8. Minibus 3 për 20 udhëtar, tabela 02-458-DH, regjistrim deri me 25.11.2020, ka marrëveshje;
9. Mercedes 410 për 20 udhëtar, regjistrim deri me 13.12.2020, tabelat 02-650-CM;
10. Mercedes Mini bus per 20 udhëtar, regjistrim deri me 22.06.2021, tabela 678-KS-763.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pas në dispozicion si dhe në sqarimet e ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, dhe njëkohësisht obligon autoritetin kontraktues që gjatë rivlerësimit konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, ti verifikoje dhe të kërkojë sqarime shtesë për të gjitha dëshmitë-dokumentet (të OE-së të rekomanduar për kontratë), të cilat i konteston operatori ekonomik ankues sikurse në pretendimet

ankimore, më saktësisht të vërtetojë se OE i rekomanduar për kontratë për kontratë a i ka përmbush kërkesat e dosjes e tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu, Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Ministria e Arsimit;

1x1 OE "JONI TRAVEL" SH.P.K.; N.T.P "DITA"- Skenderaj;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.